



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT-OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit të Komunës së Junikut

Vendimi nr. 01/95

13.05.2026

Bazuar në nenin 58 paragraf g) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale lidhur me nenin 42 paragraf i) si dhe nenin 43 të Statutit të Komunës së Junikut nr. 001/3/27 të datës 30.09.2010, Kryetari i Komunës së Junikut merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2027-2029

I. Caktohet Grupi Punues për hartimin e Projekt-buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2027-2029, në këtë përbërje:

1. Arten Hamza- Zytari Kryesor Financiar, Kryesues
2. Florant Pepshi - Drejtorja Për Buxhet dhe Financa, Anëtar
3. Klodiana Pepshi - Drejtorja për Arsim Kultur Rini dhe Sport. Anëtare
4. Valbona Gaxherri - Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale, Anëtare
5. Florentina Qestaj - Drejtorja për Zhvillim Ekonomik, Anëtare
6. Ferdone Tofaj- Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis, Anëtare
7. Baki Krasniqi - Drejtorja për Shërbime Publike dhe Inspeksion, Anëtar
8. Sundim Krasniqi- Drejtorja e Administratës së Përgjithshme, Anëtar
9. Liberta Hoxha – Zyrtare për Barazi Gjinore, Anëtare
10. Rustem Pepshi- Zytar i IT-se, Anëtar

II. Grupi punues ka për detyrë që të hartojë Projekt-buxhetin e Komunës së Junikut për vitin 2027-2029, të bëjë hartimin e Planit të Brendshëm komunal për mbarëvajtjen e dëgjimeve buxhetore, të bëjë përgatitjen e njoftimit për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, të caktoj personin përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit gjatë mbajtjes së dëgjimeve publike dhe të bëjë hartimin e tij në afatin ligjor që parashihet në Udhëzimin Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimeve Publik, të bëjë hartimin e raportit nga dëgjimi buxhetorë dhe ta dërgoj në Kuvendin Komunal.

III. Obligohet Grupi Punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

IV. Grupi Punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

V. Obligohet Grupi punues që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

VI. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e grupit punues për hartimin e Projekt- buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2027-2029.

Vendimi i dërgohet:

1. Anëtarëve të Grupit Punues,
2. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
3. Arkivit.

